

S. K. N. Gjon Gazullë të Kol Marini

VIETA IV.

MARC 1923

Numri III.

Don' ofon fuznes fomeritor
Belge

Hylli i Dritës

Ubi Spiritus Domini, ibi libertas.
(-II ad Cor. III, 17-)

vesur arsh Dren Kullar

1. Sistemi parlamentar	Fq. 97
2. Shpresët e Shkodres	105
3. Statuti Shqyptar	111
4. Prozodì Latine	118
5. Ekspozitë pikturash komtare	121
6. Kanuni i Lekë Dukagjinit	127
7. Federata „Vatra“ e Muzika	138
8. Biblijografi	144

Pakimi D'elokei vëra me byll
grup

SHKODER
Shtypshkroja Franciskane
1923

San e kulture arsh Shqypërisja!

Posta e jonë.

Shkoder. Sh. VII. — E muerem në kujdes pûnen. Mundeni me çue me i marrë.

Shkoder Sh. I. — Do të jau çojmë dishirin në vënd.

Tiranë. Sh. C. — Nuk dim ç' me bâ me letra qi nuk kan kurrfarë nenshkrimit a vulet.

Elbasan. T. D. — Veprueme mas porosijet, por pare nuk kemi marrë. Kemi kolekcjonin e vjetëve 1921 e 1922.

Iballe. K. M. — Mundeni një herë sa per provë me na çue ndonji send. Po kje gjâ per „Hyll“ e botojmë, per ndryshejjo.

Krue. F. Ç. — Ka me ju dashtë me pritë, pse nuk kemi çka lypni. Sa per të Perkohëshme kemi ndreqë pûnë si mas shkreset.

Elbasan. A. XH. — Shpejt do t'u pergjegjemi me leter.

Kavajë. M. B. — Faji sugurisht qi s'âsht prej nesh; gjithnji ankimin e muerem në kujdes e jau çueme edhe një herë dishirin në vënd.

Vjenë. N.B. — Muerem gjithçka rregullisht e u falena nderës. Mos u merzitni per at pûnë. Kemi vanue me u dhânë të gjegjun me uzdajë se do t'u lajmojshin mirë. Shum shndet.

Zemun. L. A. — E pra u kemi shkruet. Me 10 të kti moji u kemi shkruet prap.

Fier. N. — Vjet, sa kje per jashta, la një xêvendës të vetin, por masi kthej, A. Fish ta vijoj e vijon gjithnji me këne Drejtuer i „Hyllit të Dritës“.

HYLLI I DRITËS

Vjeta IV.

MARC 1923

Numri III.

Sistemi parlamentar.

Parlamenti u çil e Statuti i Shtetit Shqyptâr, i gatuem rrokull vjetit 1922, u çpall në Fletoren Zyrtare me 27. F.uer 1923 e prandej edhe hîni në veprim. Mas kti Statuti, zgjedhjet, të cillat nuk kan me vonue shum, pse tash mâ janë bâ edhe një dishir i pergjithtë qi lypet mârrë në kujdes, nuk kan me u krye si parandej, pse n' artikull 5 lexojmë: „Perfaqësija permlidhet në një Parlament të perbâm prej deputetnish të zgjedhun prej popullit me votim t'unjishem“ (suffrage universel). Por mâ fort se dishir per zgjedhje, kemi pasë rasë me vû n'oroe se shumica e popullit ka diftue sidomos dishir per një Asemble, në të cillen, tuj u peshue prej perfaqësuesëve të popullit veprimet a provët e bâme deri tash per me e drejtue Shtetin Shqyptâr, të shifet se çka âsht nevoja me hjekë a me shtue e t' i nepet kshtu Shtetit një rregullim definitiv, masi pezullimet nder çashtje kso dore janë gjithmonë të damshme e prandej kurr per dobi per kûdo njeti, jo mâ per Shtetin e ri e të vogel t' onin, të cillit, si mrëndë si jashtë, gjindet edhe sot se kush mund i kercohet.

E një nder çashtje mâ me randsi, pse çashtje jete, persa na e mërr mëndja ne, kishte me kënë pûna e Parlamentit, ase sistemi parlamentar, tuj peshue mirë a i pershtatet a jo gjêjes s' onë e shpirtit komtar.

Tuj folë permî ket institucion politik në Numrin e kaluem na patem thânë, se një parlament souverain e i pa farë kontrolit të një Senatit a Kshillit të Naltë nuk na dukej se perkote

